



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstva za Obrazovanje
Nauku, Tehnologiju i Inovacije-Ministry of Education Science, Technology and Innovation*

Datë : 15.11.2021

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të Ligjit nr. 04L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore

Shpall:

KONKURS

Për ndarjen e çmimit vjetor

**“Shkencëtari/ja i/e vitit 2021” dhe
“Shkencëtari/ja i/e ri/re i/e vitit 2021”**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka krijuar një fond për çmime vjetore për rezultate të jashtëzakonshme hulumtuese-shkencore brenda një periudhe njëvjeçare (rezultatet shkencore nga shtatori 2020 deri në tetor 2021). Këto çmime synojnë të promovojnë cilësinë në punën shkencore, të inkurajojnë ngritjen në karrierë dhe shpërblimin e përpjekjeve dhe përkushtimin e hulumtuesve shkencorë të cilët janë në proces të avancimit të diturive të tyre në fushën përkatëse të ekspertizës. Këtë vit do të ndahen 3 (tri) çmime për “Shkencëtarin/en e vitit” dhe 3 (tre) çmime për “Shkencëtarin/en e ri/re të vitit”.

Kriteret e aplikimit

Mund të aplikojnë shkencëtarët kosovarë të çdo disipline shkencore, të cilët kanë dëshmuar rezultate të larta të punës kërkimore-shkencore. Kandidatët duhet të jenë shtetas të Kosovës dhe duhet të dorëzojnë së paku 3 (tri) rekomandime nga shkencëtarë të tjerë apo institucione kërkimore shkencore. Kandidati duhet të sjellë një CV dhe një listë, lehtë të verifikueshme, të botimeve apo të rezultateve shkencore brenda periudhës së përcaktuar.

Financimi që është vënë në dispozicion

Çmimi "Shkencëtari/ja i/e vitit", përfshin një shpërblim prej 2000 euro për të mbështetur vazhdimin e punës së tyre hulumtuese dhe për të inkurajuar fituesit e çmimit për angazhimin në nisma të reja hulumtuese. Një shkencëtar mund ta fitojë çmimin vetëm njëherë në karrierën e tij shkencore. Për një vit nuk mund të ndahet më shumë se një çmim për një fushë të caktuar shkencore.

Çmimi "Shkencëtari/ja i/e ri/e i vitit", përfshin një shpërblim prej 1500 euro dhe do të jepet në baza vjetore për 3 (tre) shkencëtarët që janë në fillet e para të karrierës kërkimore dhe që kanë dëshmuar rezultate dhe potenciale të larta shkencore dhe hulumtuese.

Konkursi mbetet i hapur nga data: 15.11.2021-30.11.2021

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHTI, zyra nr. 4, kurse për informata shtesë mund të orientoheni tek zyrtari kontaktues në MASHTI z. Fidan Kozhani, fidan.kozhani@rks-gov.net në zyrën 302 b, kati 3

Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar "Aplikimi për çmimin "Shkencëtari/ja e/i vitit 2021" apo "Shkencëtari/ja/ i/e ri/e i vitit 2021" në adresën : Rr. "Agim Ramadani" p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Përpos kësaj, një version elektronik i aplikimit duhet të jetë dorëzuar së bashku me dokumentacionin përfundimtar brenda datave të lartcekura.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.